



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Këshilli Ministrave

Nr. prot. _____, datë ____.

Shkurtimi i lëndës Venedim

Për trajtim:	<u>SP</u>
Për dijeni:	<u>Kabineti</u>
Me porosi :	<u>Të ujoftohet Gr. Politi</u> <u>Të udhëzot sipas fjalës së</u> <u>UNIVERSITETIT DË PAS RENAZHONIS</u>

Afat Normal 7 ditë Prioritet 3 ditë Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/Për dijeni

Data 8.4.2019, Nr. prot. 2361, Nënshkrimi (TITULLARI) [Signature]

Marrë në dorëzim nga kabineti dt 9.04 Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim Esso! Të ujoftohet datë ____.

Me porosinë: Nesolo Anto _____

Marrë në dorëzim ____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim _____ datë ____.

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim ____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim Specialistit _____ datë ____.

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më : ____ Specialisti _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 188, datë 13.3.2019

PËR

**OFRIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
TË SHËRBIMEVE, NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E TYRE,
PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE
DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të neneve 18, 19 e 95, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore apo institucionet në varësinë e tyre të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.
2. Për shërbimet e ofruara sipas këtij vendimi, institucionet publike të arsimit të lartë zbatojnë tarifat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe, në mungesë të tyre, miratojnë tarifa me akte të brendshme. Tarifat e miratuara me akte të brendshme duhet t'u referohen kontratave për punë të ngjashme dhe, në mungesë të tyre, t'i referohen mesatares së vlerave të tregut për shërbimin përkatës të kërkuar.
3. Bordet e administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë miratojnë tarifat për shërbimet e ofruara për institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe për të tretët.

4. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nënshkruajnë kontratë shërbimi me titullarin për çështjet financiare dhe administrative të institucionit publik të arsimit të lartë.
5. Grupi i punës, mënyra e administrimit të të ardhurave dhe masa e shpërblimit të personelit akademik dhe/ose studentëve të angazhuar në ofrimin e shërbimit rregullohen me procedura të brendshme të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Përparësi në rastet e ofrimit të shërbimeve kanë ato IAL, të cilat kanë marrëveshje partneriteti me ministrinë e linjës. Në rastet kur një shërbim ose kategori shërbimesh ofrohet nga më shumë se një IAL publik dhe nuk ka marrëveshje partneriteti, përzgjedhja nga ana e institucioneve publike duhet të kryhet bazuar mbi ofertën më të mirë.
7. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, vijojnë me procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur:
 - a) cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë nuk është sipas marrëveshjes së nënshkruar;
 - b) shërbimet e kërkuara nuk mund të realizohen nga institucionet publike të arsimit të lartë;
 - c) tarifat e ofruara nga këto institucione nuk janë sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
8. Të gjitha institucionet e pavarura kanë të drejtë që, sipas nevojave të tyre, të kërkojnë shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.
9. Ngarkohen Kryeministria, ministrinë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

BESA SHAHINI

NR.PROT.1725/1
DATË 5.11. 2019

KRYEMINISTRISË
MINISTRIVE
UNIVERSITETEVE PUBLIKE SHETËRORE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

